

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

N. 15468..... Rep.

N. 2004..... Kol. 13



AKT THEMELUES

I

Shoqerise Tregetare "LARISA & B" sh.p.k.

Sot, me daten 16/12/2006 (gjashte), para meje Noterit, Agim Xh. Robo, anetar i Dhomes se Noterise Tirane, me seli ne Rruget Ismail Qemali, P. 27/1, u paraqit personalisht :

Vesel Ramazan Demiraj , qytetar shqiptar, lindur ne Durrës me 13 shkurt 1967 , banues ne Tirane, Rruga " Myslym Shyri , Pallati 46 shkalla 3 , numer pasaporte Z0188962, ne baze te Ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", themelon nje shoqeri me kushtet e me poshtme:

Neni 1. Shoqeria " **Larisa & B**" sh.p.k. eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e cila themelohet e vepron ne baze te legjislacionit shqiptar.

Neni 2. Shoqeria e ka seline ne Rruga " Myslym Shyri , Pallati 46 shkalla 3 ,

Neni 3. Kohezgjatja e shoqerise fiksohet deri me 31- dhjetor 2025.

Neni 4. Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mije) leke, sipas vertetimit te Bankes bashkelidhur.

Neni 5. Shoqeria ka per objekt:

Tregtimin, eksportim, importim, transportim, me shumice e me pakice te pijeve alkolike dhe jo alkolike , mallrave dhe paisjeve te ndryshme elektronike, elektrike dhe mekanike , per vete e per te trete; ndermjetesim per shitje mallrash, marketing; administrim te pikave te shitjes me pakice dhe me shumice, sherbime te ndryshme keshilluese dhe konsulence per te trete.

Neni 6. Shoqeria administrohet nga Administratori, z.Vesel Demiraj , qytetar shqiptar, lindur Durrës me 13 shkurt 1967 , banues ne Tirane,

Rruga " Myslym Shyri , Pallati 46 shkalla 3 , nr i pasaportes Z0188962


- 2 -

Neni 7 Rregulla me te hollesishme per organizimin dhe drejtimin e shoqërisë gjenden ne statut qe eshte pjese perberese e kesaj kontrate.

Ky dokument redaktohet ne kater kopje origjinale.

Akt – Themelimi perpilohet ne baze te vullnetit te lire dhe te plote te themeluesit dhe pasi lexohet me ze te larte, deklarohet se eshte kuptuar, miratohet dhe firmoset rregullisht prej tij dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

ORTAKU I VETEM
VESEL DEMIRAJ



NOTER
Agim Xh. Robo



STATUTI

I Shoqerise " Larisa &B" sh.p.k.



Neni 1 - Forma e Legjislacioni

Shoqeria "Larisa & B " sh.p.k. (me poshte e quajtur shoqeria) eshte nje shoqeri tregtare private e regjistruar ne Republiken e Shqiperise ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar sipas Ligjit nr.7638,date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe qe e kryen aktivitetin e saj ekonomik sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 2 - Miratimi

Shoqeria fiton te drejtat e personit juridik nga data e marrjes se vendimit perkates nga ana e Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 3 - Selia

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, Rruga " Myslym Shyri " Pallati 46 shkalla 3 ,

Ajo mund te transferohet ne çfaredo vendi tjeter brenda qytetit te Tiranes ose ne ndonje qytet tjeter te Republikes se Shqiperise me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Shoqeria mund te hape filiale, dege apo perfaqesi te saj ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj te cilat do te krijohen ne baze te legjislacionit shqiptar dhe ate te vendeve ku do te ngrihen.


Neni 4 - Kohezgjatja e veprimtarise

Kohezgjatja e shoqerise fiksohet deri ne 31-dhjetor 2025 dhe mund te zgjatet ose te zgjidhet para kohe me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 5 - Objekti

Shoqeria ka per objekt:

Tregtimin, eksportim, importim, transportim, me shumice e me pakice te pijeve alkolike dhe jo alkolike, mallrave e paisjeve te ndryshme elektronike, mekanike, per vete e per te trete; ndermjetesim per shitje mallrash, marketing; administrim te pikave te shitjes me pakice dhe ose shumice sherbime te ndryshme keshilluese dhe konsulence per te trete.



Neni 6 - Kapitali themelor


Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke i vendosur nga z. Vesel Demiraj, ortak i vetem i shoqerise, i ndare ne 100 kuota vlera nominale e te cilave eshte 1.000 leke. Kapitali themeltar i shoqerise ne asnje rast nuk duhet te jete me i vogel se shumja e permendur me lart ne kete nen.

Neni 7 - Kushte ekonomike

Ortaku i vetem i shoqerise “ **Larisa &B**” sh.p.k. perballon humbjet e saj vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin themelor.

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejten e perdorimit dhe disponimit te kesaj pasurie ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen.

E ardhura bruto e shoqerise, pasi zbriten amortizimi i te gjitha pasurive te luajteshme e te paluajteshme, sipas niveleve te miratuara, pagat, shitesat mbi page dhe shpenzime te tjera qe lidhen me to, shpenzimet per lendet e para apo ndihmese, energjine si dhe shpenzime te pergjitheshme te reparteve te shoqerise, ato prodhuese e jo prodhuese, humbjet e vitit te meparshem, çdo shpenzim i lejuar dhe taksa mbi fitimin, merret nga ortakut i vetem i shoqerise.

Shoqeria gjithashtu nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar le menjane nje shume me vlere te pakten 1/20 e tij e cila destinohet per formimin e fondit rezerve derisa ky fond te arrije 1/10 e kapitalit themelor.

Veprimtaria do te zhvillohet ne baze te parimeve ekonomike dhe do te pasqyrohet periodikisht ne bilancet dhe llogarite vjetore perkatese sipas legjislacionit te kontabilitetit ne fuqi. “

Neni 8 - Trashegimia e transferimi


Kapitali themeltar eshte lirisht i trashegueshem ne rruge trashegimie. Ai eshte lirisht i transferueshem ne rast te ndarjes se pasurise midis bashkeshorteve, paraardhesve e pasardhesve. Ai gjithashtu eshte lirisht i transferueshem tek persona te trete me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 9 - Kontrata e punes

Marredheniet e punes ne shoqeri, filial apo dege rregullohen ne baze te kontrates se punes qe lidhet midis punonjesit dhe drejtuesve te shoqerise. Per çeshtjet qe nuk rregullohen ne te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar te punes.

Neni 10 - Administrimi

Shoqeria drejtohet nga Administratori i saj. Ortaku i Vetem eshte organi vendimor i shoqerise i cili ka gjitha kompetencat dhe fuqite per te marre vendimet



perkatese ne lidhje me ndryshimet ne statut, shtimin apo pakesimin e kapitalit themelor, emërimin e administratoreve, te eksperteve kontabel, zgjatjen ose pushimin e veprimtarisë dhe hapjen ose mbylljen e filialeve.

Organi administrativ i shoqerise eshte Administratori, i cili zgjidhet nga Ortaku i Vetem, çdo tre vjet. Administratorit i jepen te gjitha kompetencat per administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise pa kufizim, per arritjen dhe kryerjen e objektit shoqeror me perjashtim te kompetencave te siperpermendura qe statuti ja rezervon Ortakut te Vetem. Pra Administratorit i takon perfaqesimi i shoqerise para te treteve, ne gjykate e arbitrazhe, para administrates shteterore e organeve financiare.

Neqoftese ne mbyllje te vitit financiar realizohen dy prej shifrave te permendura ne nenin 65 te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" Ortaku i Vetem emerone nje ekspert kontabel.

Neni II - Likujdimi

Aktiviteti i shoqerise mund te pushoje ne rastin e parashikuar ne nenin 4 te ketij statuti ose ne raste te tjera te parashikuara ne ligj.

Shoqeria mund te mbyllet ne formen e riorganizimit ose te likujdimit. Ne rastin e likujdimit, Ortaku i Vetem emerone nje likujdator i cili vepron ne baze te dispozitave perkatese ne fuqi.

Neni 12 - Referimi ne ligj

Persa nuk eshte parashikuar ne statut i referohet ligjit perkates ne fuqi.

Hartuar ne kater kopje, me 16 / 12 / 2006

ORTAKU I VETEM

Vesel Demiraj



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA TIRANE

Nr. 75469 Rep.

Nr. 2005 Kol. 13

VERTETIM

Sot me daten 16 / 12 / 2006 (dymijegjashte), u prezantua ne Zyren Noteriale, Tirane, Rruga Ismail Qemali, P.27/1, zoti si perpilues te dokumentave te shoqerise " **Larisa & B**" sh.p.k., i panjohur prej meje por qe per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta perkatese, madhor e me zotesi per te vepruar. Dokumentat jane konform Ligjit te Shoqerive ne fuqi. Mbas leximit ai deklaroi se i kuptoi dhe me vullnetin e tij te lire firmosi rregullisht para meje Noterit.

